

## POZICION VAKANT

**Balkan Finance Investment Group**, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Holandë, me afërsisht 6,000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Kompania **Mane TCI**, pjesë e Grupit BALFIN, është lider në ndërtim dhe investim të projekteve zhvilluese, në Shqipëri dhe rajon. E themeluar në vitin 2001, Mane TCI është e specializuar në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale, si: Qendra Tregtare, Godina Rezidenciale, Qendra Sociale dhe Kulturore, ndërtime industriale dhe infrastrukturë.

**Pozicioni:** Inxhinier QA  
**Departamenti:** HSE & QA  
**Vendndodhja:** Palasë

**Përmbledhja e Pozicionit:** Inxhinier QA është përgjegjës që kompania të përmbushë kërkesat ligjore dhe kërkesat e derivuara nga procedurat e cilësisë. Ndjek zbatimin e procedurave me nënkontraktorët, procesin e testeve laboratorike për kampione të ndryshme materialesh dhe sigurohet që çdo gjë është në përputhje me standardet.

### Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Siguron se kompania përmbush kërkesat ligjore dhe kërkesat e derivuara nga procedurat e cilësisë;
- Përmirëson dhe implementon procedurat e kompanisë;
- Ndjek çdo kantier për zbatimin e procedurave të cilësisë sipas kompanisë;
- Ndjek procesin që kryhet nga inxhinierët e caktuar në objekt për marrjen e mostrave dhe analizimin e tyre në laboratorët e akredituar dhe të licensuar nga DPSH. Sigurohet që të jenë dokumentuar rezultatet e testit, procesin e monitorimit dhe regjistrimin e të dhënave;
- Përgatit dosjen e cilësisë për materialet specifike të importit që nuk ka mundësi të analizohen në laboratorët tanë;
- Ndjek zbatimin e cilësisë në procese të ndryshme teknologjike gjatë zbatimit të punimeve;
- Harton recepturat për betonet e veçanta dhe të llaçeve;
- Harton proces-verbale për materialet dhe punimet me cilësi të dobët;
- Plotëson dokumentacionin përkatës të cilësisë për çdo objekt;
- Ndjek kontrollin e cilësisë së punimeve për të gjitha kantieret e ndërtimit;
- Mbikëqyr zërat e punës për të siguruar standarde cilësie krahasuar me specifikimet teknike;
- Ndhmon ekipet ose nënkontraktorët për të zbatuar informacionin që ndikon në përmirësimin e procesit dhe zgjidhjen e çështjeve të cilësisë;

- Në mënyrë periodike kryen trajnime të stafit teknik për cilësinë;
- Në mënyrë periodike kryen inspektime të punimeve dhe detajeve teknike për cilësinë dhe përgatit raporte teknike;
- Ndjek cilësinë e lëndëve të para që vijnë në kantier nga furnitorët e ndryshëm;
- Aprovon materialet që implementohen në kantiere;
- Përpara dorëzimit të punimeve kryen inspektime për cilësinë në njësitë/punimet që dorëzohen tek investitori;
- Përgatit periodikisht 2 herë në muaj, Raport Teknik për punimet dhe materialet për Construction Manager dhe Project Manager Rajonal;
- Detyra të tjera që i ngarkohen.

**Edukimi:** Të zotërojë diplomë universiteti në Inxhinieri Ndërtimi

**Kualifikime të tjera:**

- Certifikatë që tregon pjesëmarrjen në kurse specifike për cilësinë;
- Njohuri shumë e mirë e standardeve të cilësisë;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi për të punuar në skuadër dhe për të gjetur zgjidhje;
- Aftësi të mira komunikuese dhe ndërpersonale;
- Njohuri shumë e mirë në përdorimin e programeve kompjuterike (Paketa Microsoft Office, etj).

**Mënyra e aplikimit:**

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit në [link](#).  
Pas shqyrtimit do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

**Afati i dorëzimit: 13/07/2022**

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*